



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 630/ prot.

Gjirokastrë, më 15 . 05 .2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut.

KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET
Përmet

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 64, datë 1.7.2026, “Për disa ndryshime në VKB nr. 113, datë 17.12.2025, ‘Për miratimin e buxhetit të bashkisë viti 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve dhe njësive administrative në varësi të saj, i ndryshuar”, konfirmohet.

2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 65, datë 1.7.2026, “Për miratimin e rregullores së brendshme për zbatimin e ligjit 86/2025, datë 11.12.2025, ‘Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë’ dhe udhëzimit nr. 11, datë 14.05.2026, ‘Për zbatimin e ligjit nr. 86/2025 të Ministrisë së Financave”, nuk konfirmohet.

a) Ligji nr. 86/2025, neni 13, pika 2, përcakton se: “Ky ligj i shtrin efektet nga data 1 janar 2026 deri në datën 31.12.2026”. Rregullorja e këshillit bashkiak në nenin 9, pika 3, zëvendëson në kundërshtim me ligjin datën e fillimit të efekteve të ligjit nga data 1.1.2026, në datën 14.5.2026. Gjithashtu, edhe te dispozitivi i vendimit të këshillit, pika 3, përcaktohet në të njëjtën mënyrë që efektet e veprimit të tij fillojnë në datën 14.5.2026.

b) Neni 7, pika 1, shkronja “c”, e rregullores parashikon faljen e gjobave/kamatëvonesave vetëm si pasojë e një pagese TË RE prej 50% ose 75% të pjesës së mbetur të detyrimit. Rregullorja kalon më pas direkt nga pika 1 te pika 3, pa parashikuar rastin kur principali është shlyer plotësisht më parë, subjektit i aplikohet automatikisht fshirja/shuarja e gjobave dhe kamatëvonesave, ashtu siç e përcakton kreu V, pika 5, e udhëzimit nr. 11/2026, ‘Për zbatimin e ligjit nr. 86/2025, “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”.

c) Neni 4 i rregullores përcakton përfituesit "sipas neneve 5, 6, 7", duke lënë jashtë nenin 11. Ligji nr. 86/2025, neni 3, shkronja "b" dhe udhëzimi nr. 11/2026, kreu II, pika 1, gërma 'b', përfshijnë shprehimisht nenin 11 në bazën ligjore të përfituesve. Heqja e referencës të neni 11 krijon paqartësi mbi trajtimin e subjekteve që janë në proces ankimi dhe kanë hequr dorë prej tij, duke ngushtuar bazën e përfituesve përtej asaj që parashikon ligji.

ç) Neni 5 i rregullores përcakton subjektet që nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve, ku përfshihen subjektet të dënuar me "vendim gjyqësor", pa kualifikuesin "të formës së prerë". Ligji nr. 86/2025, neni 4, pika 1 kërkon shprehimisht "vendim gjyqësor të formës së prerë". Heqja e kualifikuesit "të formës së prerë" zgjeron në mënyrë të paligjshme rrethin e subjekteve të përjashtuara, duke përfshirë edhe ata me vendime jopërfundimtare, në dëm të të drejtave që ligji u njeh tatimpaguesve.

d) Në vijim të nenit 5 të rregullores për subjektet që nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve, shtohet dispozita mbi subjektet e çregjistruara nga QKB, e shoqëruar me kushtin shtesë "të cilat ushtrojnë aktivitet edhe pse figurojnë të çregjistruara". Ligji nr. 86/2025, neni 5, pika 5 dhe Udhëzimi nr. 11/2026, Kreu IV, pika 5, nuk e kushtëzojnë fshirjen me vazhdimin e aktivitetit, por vetëm me faktin që detyrimi është vendosur pas çregjistrimit dhe kontabilizuar deri më 31.12.2024. Megjithëse administrativisht ky veprim i bashkisë synon të godasë informalitetin, përfshirja e kësaj dispozite brenda nenit "Përjashtimet" (kur në ligj ajo bën pjesë të "Fshirja") dhe shtimi i një kriteri që ligji nuk e parashikon, përbën tejkalim të kompetencës zbatuese të rregullores, e cila nuk mund të shtojë kushte kufizuese përtej atyre të përcaktuara në ligj.

3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 66, datë 1.7.2026, "Për një ndryshim në vendimin nr. 125, datë 17.12.2025 të Këshillit Bashkiak Përmet, 'Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Përmet dhe FSHF-së, miratimin e financimit të FSHF-së për rikonstruksionin e pjesshëm të stadiumit 'Durim Qypi', Përmet, si dhe dhënien e autorizimit të kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e saj", në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, 'Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë' nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore."

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 72, datë 1.7.2026, “Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë muaji qershor 2026”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’ nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

5. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 73, datë 1.7.2026, “Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6%”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’ nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

6. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 74, datë 1.7.2026, “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për dhënie ndihme financiare”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’ nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe

urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

